

VENDIM
Nr. 98, datë 30.4.2018

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS
PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË
REZULTON PAS PËRMBUSHJES
SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL,
ME QËLLIM MBULIMIN
E HUMBJEVE NË RRJETIN
E SHPËRNDARJES PËR PERIU DHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 5, të VKM-së nr. 244 datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 3998/1 prot., datë 6.3.2018, ka përcjellë në ERE draftin e “Kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.

- Në datë 7.3.2018, u depozitua në ERE shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr. 1017/3, datë 7.3.2018 dhe nr. 186/7 prot., datë 7.3.2018 të ERE-s me “Draftkontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.

- KESH sh.a. bën me dije se pavarësisht diskutimeve për të arritur në një draft të dakordësuar të kësaj kontrate, ka pasur dispozita të saj të cilat nuk kanë gjetur dakordësinë e Palëve.

- Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ndryshuar me VKM-në nr. 729, datë 8.12.2017 përcaktohet se: kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE.

- Me vendimin nr. 56, datë 9.3.2018, bordi i ERE-s vendosi “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Draftkontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.

- Në vijim të konstatimeve sa më sipër, në datën 30.3.2018, ERE organizoi një seancë dëgjimore me palët e interesit, ku nuk mungoi përfaqësimi nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

- Në seancë, përfaqësuesit e KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. bënë me dije se kanë gjetur dakordësinë në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 dhe me shkresën nr. 7195/1 prot., datë 26.4.2018, OSHEE sh.a. ka përcjellë në ERE draftkontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e

humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, me propozimin e saj final.

- Nga shqyrtimi i propozimeve të sjella nga palët, në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 të kësaj kontrate, konstatohet se sa parashikuar në përmbajtjen e këtij vendosja e një afati më tolerant, prej 10 ditësh për paraqitjen e faturës u vendos në referencë të marrëveshjeve dhe kontratave të tjera të ngjashme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2018.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



Nr. __ prot., datë __.__.2018



Nr. __ prot., datë __.__.2018

KONTRATË

NDËRMJET KESH SHA DHE OSHEE SHA/OSSH PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018

E lidhur sot në datën __.__.2018, ndërmjet:

Korporatës Elektroenergetike Shqiptare, KESH sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12728, datë 6.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në rrugën “Eshref Frashëri”, kompleksi Vizion, nr. 8, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga z. Agron Hetoja, administrator i shoqërisë KESH sh.a., që më poshtë do të quhet “Shitësi”,
dhe

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a./OSSH), regjistruar si person juridik me vendimin nr. 38587, datë 19.6.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në

bulevardin “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88 H.I, Njësia Administrative nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i K72410014H, përfaqësuar nga _____, që më poshtë quhet “Blerësi”,

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe më vete si “Pala”).

Baza ligjore: ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimi nr. 244, datë 30.3.2016, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, vendimi i bordit të ERE-s nr. 139/2016 “Për miratimin e rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimi i bordit të ERE-s nr. 193/2017 “Për miratimin e rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, i ndryshuar.

Në kushtet kur në pikën 4, të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se: “Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas pikës 2, të këtij neni, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit mesatar të Bursës Hungareze, HUPX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse dhe përcaktohet, në mënyrë të detajuar, në kontratë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE”.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

KESH sh.a., i cili më poshtë do të quhet “Shitësi/Furnizuesi” dhe OSHEE sh.a./OSSH (në funksionin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes), që më poshtë do të quhet “Blerësi”, lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë me objekt shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

Neni 2

Detyrimet kryesore të palëve

1. OSHEE sh.a./OSSH, përpara çeljes së procedurës së blerjes në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të njoftojë KESH sh.a. për sasinë e energjisë elektrike që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar me këtë rast KESH sh.a. informacion mbi mundësinë që kjo e fundit ka për të furnizuar sasinë e energjisë elektrike që kjo e fundit mund t’i shesë për mbulimin e tyre, sasi e cila mund të mbulojë pjesërisht apo plotësisht kërkesën për mbulimin e humbjeve.

KESH sh.a., përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike, pasi ka përmbushur detyrimin kontraktual për FSHU-në për furnizimin e klientëve fundorë, do t’i komunikojë shoqërisë OSHEE sh.a./OSSH mundësinë e furnizimit me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energjisë elektrike të ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e

humbjeve.

2. Nëse të dyja palët bien dakord për shitjen/livrimin e plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, atëherë programimet, nominimet, konfirmimet, livrimi dhe matja do të bazohen në Rregullat në fuqi të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim.

Neni 3

Çmimi

Çmimi për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë çmimi mesatar i Bursës Hungarez HUPX për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë elektrike për produktin/profilin band, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse.

Neni 4

Faturimi dhe pagesa

1. Blerësi, brenda datës 5 të muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike, do t'i konfirmojë me shkrim shitësit informacion mbi sasinë e energjisë elektrike që ka rezultuar e furnizuar për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Shitësi do t'i lëshojë Blerësit, brenda datës 10 të muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike, një faturë ku të pasqyrohet sasia dhe vlera totale e energjisë elektrike që ka rezultuar e livruar për mbulimin e humbjeve në sistemin shpërndarjes gjatë periudhës përkatëse.

3. Pagesa e faturës nga ana e Blerësit, do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e lëshimit të faturës përkatëse nga ana e Shitësit dhe nëse dita e fundit nuk është ditë pune, ditën tjetër të punës.

4. Vonesa në kryerjen e pagesës; Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5

Mosperformanca për shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësimit të kërkesës për klientët tariforë

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese"), që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimi, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:

a) Defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterike të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimi; ose

b) Pezullimi nga OST-ja përkatëse e livrimit, pranimi ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me programimin sipas kontratës;

c) Defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes;

d) Defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të KESH sh.a.

2. KESH sh.a. nuk do të shesë/livrojë energji elektrike për OSHEE sh.a./OSSH për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në kushtet kur e ka të pamundur plotësimin e sasisë kontraktuale me FSHU-në për furnizimin e klientëve fundorë.

3. Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive, të përcaktuara në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e

saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasisë e palivruara ose të pamarra.

4. Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimin të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

5. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të livrimit.

6. Në rast të moslivrimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslivruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimin më të lartë, nëse ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palivruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë së cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.

7. Në rast të mospranimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit, sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimin më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë së cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.

Neni 6

Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi i RSH-së.

2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me kontratën do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë, gjithashtu, zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7

Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme

1. Kjo kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga ERE dhe i shtrihet efektet nga data 1 janar 2018.

2. Ajo mund të përfundohet, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga ERE.

Neni 8

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, 2 (dy) për secilën palë.



ADMINISTRATORI
Agron Hetoja



ADMINISTRATORI